



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Prishtinë, 23.06.2018

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore:

SHPALL KONKURS

Titulli i punës : Zyrtar i lartë për Trashëgimi Kulturore

Nr.i ref.: RN00003391

Koeficienti: 8

Lloji i pozitës: E karrierës

Orët e punës: 40 orë në javë

Vendi i punës: Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës: Zyrtari i Lartë për Trashëgimi do të kryej të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që lidhen me trajtimin dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore arkitekturale për shpallje në mbrojtje të përhershme. Përgjatë punës se tij, zyrtari do të përkrah Udhëheqësin e drejtpërdrejtë dhe Udhëheqësin Ekzekutiv në hartimin e politikave dhe programeve që lidhen më ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale me theks të veçantë trashëgiminë kulturore arkitekturale.

Nëpunësi raporton te: Udhëheqësi i Divizionit / Programit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

1. Pranon aplikacionet e propozuara mbi shpalljen e trashëgimisë kulturore arkitekturale në mbrojtje të përhershme;
2. Analizon dhe shqyrton në përputhje me procedurat e përcaktuara, parimet, kriteret dhe rregullat në fuqi;
3. Përgatit raportin me rekomandime për shpallje ose refuzim të trashëgimisë kulturore arkitekturale në mbrojtje të përhershme;
4. Pranon projektet e propozuara nga fusha e trashëgimisë kulturore, i analizon dhe i shqyrton nëse janë në përputhje me procedurat e përcaktuara;
5. Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike, kur kërkohet një gjë e tillë;
6. Ofron këshilla për stafin më të ulët për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;
7. Në bashkëpunim më udhëheqësin e drejtpërdrejtë koordinon përgatitjen e programit për vetëdijesim publik, për nxitjen e arsimit, ngritjen e vetëdijes, partneritetit dhe bashkëpunimit në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
8. Ofron këshilla në fushën e ekspertizës se kërkuar brenda institucionit;
9. Përgatit raporte periodike mbi aktivitetet organizative dhe çështjeve që kërkojnë shqyrtim nga Udhëheqësi Ekzekutiv;

10. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi
11. Për punën e vet i përgjigjet Udhëheqësit të Divizionit

Shkathtësit e kërkua:

- Diplomë universitare në: arkitekturë, trashëgimi kulturore;
- 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me trashëgimi kulturore;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Njohuri të avancuar të punës me kompjuter (MS Word, Excel, Auto CAD, 3d Max, Archi CAD).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 kati i II (dytë) zyra nr.206, Prishtinë, Kosovë ose forma elektronike <http://kktk.rks-gov.net>. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni Tel: +381 (0) 38 211 617, prej orës 08:00-16:00. Konkursi është i hapur nga data 23.06. 2018 deri me datë 07.07.2018.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen". Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontakohen.